

**SHTOJCA Nr. 4 E BROSHURËS INFORMATIVE PËR APLIKUESIT PËR
MBROJTJE NDËRKOMBËTARE (IPO 1)**

NJOFTIM INFORMATIV

**INFORMACION LIDHUR ME KOHËN E NDALIMIT TË
SHQYRTIMIT TË KTHIMIT TË DETYRUAR NË BAZË TË NENIT 50 TË AKTIT
PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE 2015**

Nga **1 Janari i vitit 2020**, për aplikuesit e rinj për mbrojtje ndërkombëtare, neni 50 (ndalimi i *kthimit të detyruar*) do të merret në konsideratë vetëm nëse kriteret e përcaktuara në nenin 51 (1) (a) deri (c) të aktit 2015 mund të zbatohen për një person, gjegjësisht atëherë kur Ministri

- (a) ka refuzuar në bazë të nenit 47 që t'i japë deklaratë për status refugjati dhe t'i japë mbrojtje shtesë personit, dhe
- (b) është i pajtimit që neni 48 (5) nuk zbatohet në lidhje me personin, dhe
- (c) ka refuzuar në bazë të nenit 49 (4) që t'i japë personit një leje në bazë të këtij neni.

Ministri nuk do të formojë më mendim mbi ndalimin e *kthimit të detyruar* në bazë të nenit 50, kur të shqyrtojë se a do t'i japë një aplikuesi lejeqëndrim në bazë të nenit 49.

Në lidhje me këtë, nëse shqyrtimi sipas nenit 50 vendos se neni 50 (1) zbatohet në atë rast, do t'i dërgohet një letër personit për ta njoftuar atë se i është dhënë leje që të qëndrojë këtu, nën nenin 50 (4). Sidoqoftë, nëse shqyrtimi sipas nenit 50 vendos se neni 50 (1) nuk zbatohet në atë rast, një raport në bazë të nenit 50 do t'i dërgohet personit me njoftimin e urdhrin për deportim, të lëshuar në bazë të nenit 51 (3) të Aktit 2015.